



**Datë:** 18.07.2025  
**Numër Protokolli:** 5067/2025

**A.nr.1009/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1009/2025, të datës 29.05.2025, të parashtruar nga ankuesja E.G kundër organit të punësimit/Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.07.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Detyrohet** Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesja E.G, dhe të nxjerrë nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**II.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Nëpunësja civile, E.G (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), me datë 29.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nën shenjen A.nr.1009/2025 dhe numër protokolli:3625/2025, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, ndaj kërkesës së datës 18.03.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 10.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 16.06.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: *Kolegji i Këshillit*) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3615/2025 të datës 29.05.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimin me Nr.01-112-34 të datës 16.11.2024; Dokument identifikimi; Formularin për kërkesë apo ankesë; Listat e pagave të ankueses; Kërkesë për përgjigje në ankesë 10.06.2025; Përgjigje në ankesë e datës 16.06.2025; Kërkesën e datës 18.03.2025; Akt emërimin me 01nr.112-34 të datës 01.02.2017.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankueses, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 18.03.2025 të parashtruar nga ankuesja, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja sipas Akt Emërimit me shifër 01nr.112-34 të datës 01.02.2017, është e punësuar në Komunën e Prishtinës, në pozitën “Zyrtare për Gjendje Civile”, në kuadër të Drejtorisë së Administratës, ndërsa organi i punësimit me datë 16.11.2024 i ka lëshuar Aktin e emërimit me shifër Nr.01-112-34, ashtu që pozitën e ankueses “Zyrtare për Gjendje Civile”, e ka klasifikuar në Kategorinë Profesional 2, me klasë dhe koeficient të pagës, GJ33, 5.1.

Ankuesja, me datë 18.03.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me kërkesën, për kompensim material sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33 duke iu referuar Aktit të Emërimit të lëshuar me datë 19.11.2024 nga Komuna e Prishtinës/Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, duke shtuar se është duke u paguar sipas koeficientit 4.50, GJ41-4, Profesional 3, ndërsa sipas shkresave të lëndës konstatohet fakti se organi i punësimit ka heshtur lidhur me kërkesën e ankueses të datës 18.03.2025.

Kundër heshtjes administrative të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesja me datë 29.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimin ankimor se i njëjta është duke u dëmtuar financiarisht, pasi që pavarësisht faktit se organi i punësimit i ka lëshuar Aktin e emërimit me koeficient 5.1, i njëjti nuk është duke u kompensuar sipas koeficientit të ri, më kërkesën që organi i punësimit të zbatoj Aktin e emërimit me shifër: Nr.01-112-34 të datës 16.11.2024, dhe ta kompensojë ankuesen në mënyrë retroaktive sipas nga koeficienti 4.5 në 5.6 dhe atë që nga data e nënshkrimit të këtij akt emërimit deri në nxjerrjen e vendimit të Këshillit.

Këshilli në kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.06.2025 ndër tjerash kishte kërkuar prova dhe sqarime nga Komuna e Prishtinës, si në vijim: “*Dëshmi nëse organi i punësimit/Komuna e Prishtinës ka përfunduar klasifikimin e vendeve të punës sipas Rregullores Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës*”, kurse kjo e fundit në përgjigjen në ankesë të datës 16.06.2025, nuk kishte dhënë sqarime lidhur me këtë kërkesë.

Lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, konstaton se meqë pala ankuese, me datë 18.03.2025 ka parashtruar kërkesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, atëherë Kolegji i Këshillit lidhur me obligimin e organit publikë që të shqyrtoj kërkesën e palës dhe të nxjerr aktin administrativ, iu referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: “*3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të*

*parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar”, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: “1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës”, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: “1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative”, në këtë rast, në kuptim të nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”, dhe për rrjedhojë konstatoi, se organi të cilit i është drejtuar kërkesa, në rrethanat e rastit konkret Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është dashur të vendos brenda afatit prej 45 ditësh, apo të aplikohet neni 99 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo meqë kërkesa e palës ankuese nuk është shqyrtuar, atëherë është aplikuar heshtja administrative.*

Sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast se organi publik hesht ndaj kërkesës së palës, atëherë palës i lind e drejta që të parashtrorj ankesë tek organi i shkallës më të lartë kundër heshtjes administrative duke u bazuar në dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse organi i punësimit ka heshtur ndaj kërkesës së ankuseses, ankesa e ankuseses e datës 29.05.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në kuadrin ligjor të cekur si më lartë, lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palës, e obligon Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, që të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës së datës 18.03.2025 të parashtruar nga ankuesja, në atë mënyrë që gjatë shqyrtimit të kërkesës të shqyrtohet të gjitha pretendimet e palës ankuese dhe të vendoset për të gjitha pretendimet në fjalë në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, sjell në vëmendje se Njësia për menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, gjatë shqyrtimit të kërkesës së datës 18.03.2025 të palës ankuese, duhet ta shqyrtoj faktin nëse akti mbi bazën e të cilit ankuesja i ka ngritur pretendimet për kompensim material, është lëshuar në pajtim me dispozitat e ligjit material, respektivisht Ligjit Nr.08/L197 për Zyrtarët Publik si dhe Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1009/2025**

**Atdhe GASHI**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses E.G;
- Komunës së Prishtinës (*Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore*); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.